



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.121/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.03.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-95968-11-26-2018 me objekt “*Rikualifikimi i Hapesirave Publike tek Zona e Plazhit te Shkemberi Kavajes*”, me fond limit 194’969’000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 27.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues:

BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk
Levan, lagjia Qendër, pranë shkollës 8 vjecare Fier

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës
Sheshi “LIRIA” Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e*

rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së BOE ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 26.11.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-95968-11-26-2018 me objekt “Rikualifikimi i Hapesirave Publike tek Zona e Plazhit te Shkembia Kavajes”, me fond limit 194’969’000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 27.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 27.12.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 15.01.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Bean	119,647,929	I skualifikuar
--------	-------------	----------------

- Caushi	120,371,358	I kualifikuar
- Shkëlqimi 07	128,875,601	I kualifikuar
- Edicom	133,002,624.51	I kualifikuar
- BE-IS	141,578,251.5	I kualifikuar
- Glavenica	101,368,841.00	I skualifikuar
- Kevin Construction	126,729,011.00	I skualifikuar
- Al-Asfalt	134,440,275.00	I skualifikuar
- Eurondërtimi 2000	140,860,296.00	I skualifikuar
- Lala	175,402,676.00	I skualifikuar
- Besta	134,899,851.00	I skualifikuar
- Company Riviera 2008	130,314,172.00	I skualifikuar
- Bajrami N	126,629,217.00	I skualifikuar
- Vëllezrit Hysa	154,363,925.00	I skualifikuar
- Liqeni VII	174,320,126.00	I skualifikuar

II.4. Në datën 15.01.2019 BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Për bashkimin e operatoreve BEAN+ED KONSTRUKSION me vlerë të ofertes 119'647'929 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, doli në përfundim se: 1- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në germen l është kërkuar: List pagesat sipas formulareve standarde për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit me kohë të plotë pune, që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 135 persona(përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës “h”) Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike). KVO duke iu referuar list pagesave të dy operatoreve ekonomik konstaton se, në list pagesat e operatorit ekonomik në bashkim BEAN, nuk janë me kohë të plotë pune, Mjekja, punonjësit e Stafit mbështetës të shoqërisë si: Punëtori e specializuar me makineri, drejtues mjeti dhe manovratorë. Punëtori e specializuar në ndërtim, karpentier, hekurthyes, saldator, elektrikist.*
- *Ndërsa në list pagesat e operatorit ekonomik në bashkim ED KONSTRUKSION, nuk janë me kohë të plotë pune punonjësit e stafit, sipas pikës “h”, konkretisht: Inxhinjeri i Mjedisit Konalsi Gjoka, Inxhinjeri Elektrik Niko Zjarri, të cilët sipas Licenses se shoqërisë ED KONSTRUKSION, janë dhe drejtues teknik, se bashku me inxhinjeren Peva Collaku, ku dhe kjo e fundit figuron në listë pagesa vetëm me dy dite pune. Gjithashtu operatori ekonomik në bashkim ED KONSTRUKSION nuk i ka derdhur kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Mjekes Valbona Salko, të cilët i ka lidhur kontrate pune që me datë 22.05.2017. Punedhënesi ED KONSTRUKSION kishte detyrimin që në bazë të Ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” detyrohet të derdhe kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo punëmarres . Për arsye të sa më sipër u citua, KVO vendos që*

bashkimin e operatoreve BEAN+ED KONSTRUKSION te mos kualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret për kualifikim, te kerkuara ne dokumentat e tenderit.

II.5. Në datën 17.01.2019 BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në lidhje me arsyet e mësipërme ju sqarojmë se: punonjësit sigurohen në listpagesë me ditë pune sipas procesit të punës dhe kohëzgjatjes që ata kryejnë. Nëse një punonjës nuk është siguruar 22 ditë pune por më pak se atë që do të thotë që ky specialist kaq ditë ka patur procesin e ngarkuar të punës. Këta punonjës janë pjesë e shoqërive dhe të disponueshëm në cdo kohë ku ka procese pune për të cilat ata janë të kualifikuar. Sqarojmë se ne si bashkim operatorësh ekonomikë kemi më shumë se 180 punonjës të siguruar , kjo është provuar nëpërmjet paraqitjes së vërtetimeve të lëshara nga DRT përkatëse me të dhënat e cdo muaji ndërkohë që në këtë procedurë referuar DST janë kërkuar 135 punonjës dhe ne e kemi tejkaluar këtë numër. Duam të theksojmë se KVO-të tuaja gjatë këtyre 6 muajve të fundit na kanë kualifikuar ne si pjesmarrës në më shumë se 12 konkurime të mëparshme në Bashkinë tuaj me po të njëjtat listpagesa të kërkuara nga ju. Gjithashtu ju bëjmë me dije se në bazë të LPP neni 20 mosdiskriminimi autoritetet duhet të shmangin cdo kërkesë, kriter apo procedurë që lidhet me kualifikimin e OE që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve, apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Vlen të sqarojmë se KVO në vlerësimin e saj duhet të marrë në konsideratë nenin 53 pika 4 të LPP. AK vlerëson një ofertë të vlefshme edhe kur ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat , kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. Sa më sipër këkrojmë kualifikimin e BOE Bean+Ed Konstruksion.*

II.6. Në datën 23.01.2019 me shkresën nr. 407/2 prot BOE Bean+Ed Konstruksion shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 25.01.2019 BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2772/1 prot datë 05.02.2019 protokolluar me tonën me nr.127/2 datë 08.02.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimes “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “Për bashkimin e operatoreve BEAN+ED KONSTRUKSION me vlere te ofertes 119’647’929 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumetacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, doli ne perfundimin se: 1- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, ne germen l eshte kerkuar: List pagesat sipas formuleve standarte për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit me kohë të plotë pune, që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 135 persona(përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës “h”) Dokumenta te konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ne fuqi (nëpërmjet formës elektronike). KVO duke iu referuar list pagesave te dy operatoreve ekonomik konstaton se, ne list pagesat e operatorit ekonomik ne bashkim BEAN, nuk jane me kohë të plotë pune, Mjekja, punonjesit e Stafit mbështetës te shoqerise si: Punëtori e specializuar me makineri, drejtues mjetei dhe manovratorë. Punëtori e specializuar në ndertim, karpentier, hekurthyes, saldator, elektrikist. Ndersa ne list pagesat e operatorit ekonomik ne bashkim ED KONSTRUKSION, nuk jane me kohë të plotë pune punonjësit e stafit, sipas pikës “h”, konkretisht: Inxhinjeri i Mjedisit Konalsi Gjoka, Inxhinjeri Elektrik Niko Zjarri, te cilet sipas Licenses se shoqerise ED KONSTRUKSION, jane dhe drejtues teknik, se bashku me inxhinjeren Peva Collaku, ku dhe kjo e fundit figuron ne liste pagesa vetem me dy dite pune. Gjithashtu operatori ekonomik ne bashkim ED KONSTRUKSION nuk i ka derdhur kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore Mjekes Valbona Salko, te ciles i ka lidhur kontrate pune qe me date 22.05.2017. Punedhene si ED KONSTRUKSION kishte detyrimin qe ne baze te Ligjit “Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise” detyrohet te derdhe kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per cdo punemarres . Per arsye te sa me siper u citua, KVO vendos qe bashkimin e operatoreve BEAN+ED KONSTRUKSION te mos kualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret për kualifikim, te kerkuara ne dokumentat e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Bean” sh.p.k & “ED Konstruksion” kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.2207 Rep, Nr.660/1 Kol datë 26.12.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “Rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit te shkëmbi i Kavajës.”.

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëritë bien dakord që shoqëria Bean të ofroj kapacitetet ligjore, teknike, ekonomike, financiare, makineritë, stafin, punë të ngjashme, fuqia punëtore. Shoqëria ED Konstruksion shpk do të ofroj kapacitetet ligjore, teknike, ekonomike, financiare, fuqinë punëtore , punë të ngajshme për realizimin e puneimeve. Bashkëngjitur kontratës gjendet edhe preventivi sipas përqindjes përkatëse të shoqërive si vijon: Punime prishje-Bean shpk, Punime ndërtime në shëtitore-Bean 70% dhe ED Konstruksion 30%, Punime Aredimi-ED

Konstruksion, Punime Elektrike në zonën e shëtitores-ED Konstruksion. Punimet do kryhen nga dy firmat dhe kryesuese do të jetë firma Bean shpk që do mbajë përgjegjësi për të gjitha punimet e përbashkëta. Punimet do të ndahen në këtë mënyrë: 61 % Bean shpk; 39% ED Konstruksion shpk.

III.1.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/l “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *List pagesat sipas formulareve standarte për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit me kohë të plotë pune, që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 135 persona(përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës “h”) Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi(nëpërmjet formës elektronike).*

III.1.3. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/h “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

a. *Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:*

➤ <i>Inxhinier Ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Arkitekt</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Inxhinjer gjeodet</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Inxhinjer Mjedisi</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Inxhinjer Elektrik</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Teknik ndertimi</i>	<i>2 (dy)</i>
➤ <i>Mjek</i>	<i>1 (nje)</i>

Stafi mbështetës i shoqërisë të ketë në përbërje:

➤ <i>Punëtori e specializuar me makineri, drejtues mjete dhe manovratorë</i>	<i>14 punonjes</i>
➤ <i>Punëtori e specializuar në ndertim</i>	
<i> karpentier</i>	<i>5 punonjes</i>
<i> hekurthyes</i>	<i>4 punonjes</i>
<i> saldator</i>	<i>2 punonjes</i>
<i> elektracist</i>	<i>2 punonjes</i>
➤ <i>Punetore ndertimi të thjeshta</i>	<i>100 punonjes</i>

Per stafin e sipercituar të paraqitet dokumentacion që verteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, licensen e mjekut, deshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj, ndërsa për punetore të thjeshta ndertimi, të paraqitet një vetëdeklarim të listës nga shoqëria, ku të deklarojë se janë punetore të thjeshta ndertimi.

Te gjithë punonjesit e sipercituar, te cilet jane pjese perberse te pikes g. “Liçensa profesionale e shoqërisë” dhe te pikes h. “Stafi teknik i shoqërisë”, te jene te perfshire ne listepagesa qe nga momeni i lidhjes se kontrates se tyre te punes.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE ankimues “Bean” shpk& “ED Konstruksion” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Maj 2018-Nëntor 2018 të operatorit ekonomik Bean shpk*
- *Listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Maj 2018-Nëntor 2018 të operatorit ekonomik “ED Konstruksion” shpk*
- *Kontratë pune lidhur ndërmjet Shoqëria ED Konstruksion shpk dhe V.S në pozicionin e Mjekes së kompanisë*
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet Shoqëria ED Konstruksion shpk dhe K.GJ në pozicionin Ing Mjedisi*
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet Shoqëria ED Konstruksion shpk dhe N.Z në pozicionin Ing Elektrik*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe B.B në pozicionin e Mjekut të shoqërisë*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe A.K në pozicionin elektrikist*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe L.S në pozicionin saladator*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe J.C në pozicionin hekurthyes*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe S.M në pozicionin hekurthyes*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe E.M në pozicionin hekurthyes*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe A.Z në pozicionin hekurthyes*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe E.M në pozicionin Karpentier*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe E.K në pozicionin Karpentier*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe A.B në pozicionin Karpentier*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe E.B në pozicionin Manovrator*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe E.O në pozicionin Manovrator*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe V.G në pozicionin shofer*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe P.S në pozicionin Manovrator dhe shofer*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe E.C në pozicionin Manovrator dhe shofer*
- *Kontratë Pune ndërmjet Bean shpk dhe R.Ll në pozicionin shofer*

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin

e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.6. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

III.1.7. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se në kërkesat kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumentacion provues se disponojnë në stafin e tyre punonjës me profesion saldator, hekurthyes, manovrator, karpentier, staf inxhinierik, inxhinier mjedisi, inxhinier elektrik, mjek, etj. Në kriterin e vecantë të kualifikimit pika h e pikës 2.3 kapaciteti teknik kërkohe shprehimisht se stafi teknik i shoqërisë”, te jene te perfshirë në listepagesa që nga momeni i lidhjes se kontrates se tyre të punës. Ndërkohë në pikën 1 të pikës 2.3 kapaciteti teknik kërkohe list pagesat sipas formulareve standarte për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit me kohë të plotë pune, që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 135 persona (përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës h).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimes konstatohet se Inxhinieri Elektrik i shoqërisë ED Konstruksion shpk N.Z rezulton në listpagesa me kohë të pjesshme. Konkretisht Inxhinieri Elektrik i shoqërisë ED Konstruksion shpk rezulton me 12 ditë punë në muaj për periudhën e kërkuar në kriterin e kualifikimit. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se punimet elektrike janë marrë përsipër të kryhen nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ED Konstruksion shpk. Në këto kushte KPP gjykon se shoqëria ED Konstruksion shpk duhet të dëshmonte se disponon në stafin e tij Inxhinierin Elektrik të punësuar me kohë të plotë sikundër kërkohe në kriterin e kualifikimit të sipërcituar.

Gjithashtu sa i takon anëtarit tjetër të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bean” shpk rezulton se ka dorëzuar dokumentacion për stafin teknik e konkretisht për punonjësit me profesion, saldatorë, manovratorë, elektrikistë, karpentier, hekurthyes. Nga shqyrtimi i listpagesave të shoqërisë lidhur me këta punonjës konstatohet se punonjësit e sipërcituar figurojnë me dy ditë punë pra me kohë të pjesshme, për të gjithë periudhën 6 mujore të kërkuar në kriterin e kualifikimit, duke mos përmbushur kështu edhe numrin e nevojshëm të punonjësve me kohë të plotë në përputhje me përqindjen e pjesmarrjes në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër KPP gjykon se BOE ankimues kanë dorëzuar dokumentacion lidhur me stafin e kërkuar si më sipër por nuk kanë mundur të përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor që këta punonjës të jenë të plesuar me kohë të plotë, kërkesë e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në këto kushte KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka plotësuar njërin nga pikat e kriterit të kualifikimit i cili kërkon shprehimisht që të gjithë punonjësit të jenë siguruar me kohë të plotë. Gjithashtu KPP vëren se në parashtrimet me shkrim ankimuesi pranon se punonjësit nuk janë me kohë të plotë duke arsyetuar se kjo përbën një devijim të vogël dhe autoriteti kontraktor duhet ta shohi si të tillë.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *" [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë*

marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimes nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bean” shpk& “ED Konstruktion” shpk për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-95968-11-26-2018 me objekt “Rikualifikimi i Hapesirave Publike tek Zona e Plazhit te Shkambi Kavajes”, me fond limit 194’969’000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 27.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 127 Protokolli; Datë 25.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

